
	Kodi i dokumentit: FO-ITWB-043		
	MARREVESHJE ME PERSONIN E CERTIFIKUAR		
kmoco@intertek-wb.com	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 1

MARRËVESHJA ME PERSONIN E CERTIFIKUAR

ITWB PROPERTY

	Kodi i dokumentit: FO-ITWB-043		
	MARREVEESHJE ME PERSONIN E CERTIFIKUAR		
kmoco@intertek-wb.com	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 2

I. SUBJEKTET

Kjo kontratë u nënshkrua ndërmjet:

Trupes Çertifikuese ITWB shpk, përfaqësuar nga njëra anë nga:

dhe

Personi i çertifikuar Z. _____

Të dyja palët ranë dakord si më poshtë:

II. OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të personit të çertifikuar dhe Trupës Çertifikuese ITWB shpk, në zbatim të skemës së çertifikimit dhe rregulloreve e mëposhtme (si dhe në pranimin e ndryshimeve / azhornimeve përkatëse);


Certifikimi sipas standarteve të mëposhtme		
<input type="checkbox"/> S SHEN ISO 17024/2012	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III. CERTIFIKIMI

Trupa Çertifikuese ITWB shpk, vendos gjithashtu edhe mbi çertifikimin e aktivitetit sipas Ligjit nr.8734 datë 01.02.2011.

Kur kjo veprimtari përmbush kërkesat e rregullores përkatës, ITWB shpk lëshon certifikatën dhe dëshminë e aftësisë përkatëse. Nëse konstatohen shkelje të kësaj Kontrate, apo dokumentat e dorëzuara pranë Trupës Çertifikuese ITWB shpk, nuk janë të sakta, personit të çertifikuar i tërhiqet çertifikimi.


IV. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

	Kodi i dokumentit: FO-ITWB-043		
	MARREVESHJE ME PERSONIN E CERTIFIKUAR		
kmoco@intertek-wb.com	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 3

Personi i certifikuar konfirmon se ai/ajo është i njohur me skemën e certifikimit dhe rregulloret përkatëse dhe se këto rregullore janë ndjekur gjatë gjithë veprimeve apo aktivitetit për të cilat është kërkuar certifikim, Rregulloret më të fundit zbatohen në cdo kohë.

Personi i Certifikuar ka për detyrë:

- a) të sigurojë dokumentet e kërkuara nga ITWB shpk.
- b) ti japë akses stafit certifikues ose personave të autorizura nga ITWB shpk lidhur me të dhëna të detyrueshme dhe dokumentacion mbështetës.
- c) të pranojë procedurën e certifikimit të ITWB shpk duke përfshirë sistemin e sanksioneve dhe masat detyruese.
- d) të paguajë tarifën e vendosura nga ITWB shpk në limitet kohore të caktuara për shërbimet e kërkuara.
- e) të informojë për çdo ndryshim thelbësor në situatën e tij ose në çdo aktivitet të lidhur me sistemin e certifikimit, në limitet kohore të caktuara.
- f) të zbatojë rregullat mbi certifikimin duke raportuar me përpikmëri çdo keqpërdorim madje dhe nga Personat të tjerë të Certifikuar.
- g) të mos e përdorë certifikatën ose logon për qëllime kundër Trupit të Çertifikimit.
- h) Të përdorë Logon dhe certifikatën vetëm siç autorizohet dhe të kufizohet nga bërja e ndonjë deklarate lidhur me certifikimin e aplikantit si psh që është i pasaktë, çorientues, ose i paautorizuar.
- i) Të jetë dakord me të gjitha politikat në lidhje me konfidencialitetin dhe përmbajtjen e provimit.
- j) Të ndërpresë përdorimin e Logos dhe certifikatës dhe kthimin e saj tek trupa certifikuese në rastet e pezullimit ose tërheqjes së saj.
- k) Të informojë Trupën Certifikuese ITWB shpk, pa vonesë, për çdo çështje që ndikon në aftësinë e individit për të vazhduar me plotësimin e kërkesave të Logos dhe certifikatës edhe atëherë kur kjo është lëshuar.
- l) të përdorin certifikatën vetëm për të treguar që janë certifikuar sipas skemës së certifikimit.
- m) të bie dakort se autoritetet dhe trupat akredituese të lidhura me ITWB shpk të kenë të njëjtin akses në vendet e punës dhe në informacione si ITWB shpk.
- n) të njoftojë ITWB shpk menjëherë, me shkrim, faks apo email, për ngjarjet apo veprimtari që mund të përfaqësojnë një shkelje të mundshme të Skemës së Certifikimit.
- o) të sillt sipas udhëzimeve dhe procedurave të Trupit Çertifikues lidhur me informimin mbi mediat, (p.sh dokumente, broshura, ose reklama).
- p) pas tërheqjes nga sistemi i certifikimit të ITWB shpk dhe/ose paraqitjes të një

	Kodi i dokumentit: FO-ITWB-043		
	MARREVESHJE ME PERSONIN E CERTIFIKUAR		
kmoco@intertek-wb.com	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 4

njoftimi të ri ndaj një Trupi tjetër Certifikimi të autorizuar, i duhet komunikuar Trupit të ri Certifikues çdo ndëshkim i aplikuar nga ITWB shpk dhe që është akoma ne fuqi.

- q) të kryejë pagesat për shërbimin e kërkuar mbi bazën e kësaj marrëveshjeje.
- r) të zbatojë certifikimin vetëm brenda skemës së certifikimit dhe fushës së zbatimit, për të cilën është lëshuar certifikimi, dhe brenda po kësaj skeme të pranojë pa paragjykime mundësinë për të bërë një ankim apo apelim.

Në rast pezullimi ose tërheqjeje të certifikimit,

- Ndalohet përdorimi i të gjithë dokumenteve që përmbajnë referenca mbi certifikimin dhe/ose ndalohet përdorimi, në rast tërheqjeje të certifikimit, i materialeve reklamuese që përmbajnë referenca mbi certifikimin. Çdo dokument kthehet me kërkesë të Trupit të Certifikimit.

V. ITWB shpk ka për detyrë:

ITWB shpk do të jetë e detyruar në përputhje me dispozitat e aplikuara legjislative. Detyrimi i saj në lidhje me çdo dëmtim të kryer nga ajo në rast neglizhence do të kufizohet në masën 300.000 leke


VI. TË TJERA KUSHTE

Periudha e vlefshmërisë të kësaj kontrate/marrëveshjeje përcaktohet nga vlefshmëria e Certifikimit të dhënë, përveç se kur nuk shfuqizohet nga palët 15 ditë përpara përfundimit të saj. Në rast se kjo nuk ndodh Organizmi Certifikues ITWB shpk planifikon automatikisht ofrimin e shërbimit për vitin pasardhës.

Të dyja palët rezervojnë të drejtën për ta ndërprerë kontratën për çështje serioze. Kjo marrëveshje do të mbarojë pa veprime të mëtejshme nëse personi i certifikuar shkel detyrimet dhe ose shkakton shkelje që mund ti shkaktojë dëme financiare ITWB shpk. Në këtë rast, ai/ajo do të konsiderohet përgjegjës për të mbuluar këto dëme financiare.

VII. PENALIZIMET DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Kjo kontratë hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

	Kodi i dokumentit: FO-ITWB-043		
	MARREVESHJE ME PERSONIN E CERTIFIKUAR		
kmoco@intertek-wb.com	Version: 1	Data Efektive: 06.11.2019	Faqe: 5

2. Kjo marrëveshje bëhet efektive pas nënshkrimit nga Personi i Certifikuar dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve që janë subjekt i saj.
3. Në rastet e përdorimit të gabuar dhe jo korrekt të logos dhe të certifikatës nga personat e certifikuar ITWB shpk merr përsipër ekzekutimin e detyrimit të pagimit të një kushti penal prej 50.000 lekësh nga shkelësit si edhe marrjen e masave që lidhen me pezullimet sipas procedurës përkatëse.
4. Pas ezaurimit të të gjitha tentativave për zgjidhje paqësore të çdo mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi që lind prej/apo në lidhje me këtë Kontratë, ose të çdo shkeljeje apo pavlefshmërie të saj, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, për të kërkuar zgjidhjen me ndërgjyqësi.

VIII. PËRFUNDIME

1. Kjo marrëveshje mund të amendohet ose të ketë shtese vetëm në qoftë se të dy palët bien dakord nëpërmjet marrëveshjes shtesë të shkruar – aneks.
2. Të gjitha të dhënat dhe informacionet ndërmjet palëve do të jenë të shkruara, dhe do të konsiderohen të plotësuar edhe kur dërgohen me fax ose email.
3. Adresat e palëve janë si më poshtë:

ITWB SHPK

.....

PERSONI I CERTIFIKUAR

.....

Kjo kontratë do të firmoset në dy kopje - një për seicilën palë. Ajo hyn në fuqi datën e firmosjes.

Për palët

Ofruesi i Shërbimit

“Inter.Tek Western Balkans” sh.p.k

Pranuesi i Shërbimit
